



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIK E KOSOVË
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPËSTINA KOMUNALE
SKENDERAJ
Nr. 01-060/01-0055276/24
Data
13.11.2024



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality Skenderaj

Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverballi i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 19.11.2024, në ora 10:00, në sallën e bordit të drejtorëve.

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton drejtori i DUMA-së, **z. Driton Mulaj**);
5. Të ndryshme.

Kryesuesja: Të nderuar anëtar KPF-së, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 6 anëtarë. Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës së bashku me 5 pikat shtesë.

Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (6) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

-Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, me Nr.06.351/01-0052104/24, i datës 13.11.2024, (Raporton Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu, në mungesë drejtorit të DUMA-së);

Drejtori i DBF-së, Ismet Aliu: Fjala përshëndetëse, në mungesë të drejtorit po e prezantoj këtë informatë nga drejtoria e urbanizmit, në pjesën e parë është Informata për leje ndërtimore, që kanë qenë 36 kërkesa në shumë prej 279,279.64€, Informate për procesin e legalizimit, që kanë qenë 18 kërkesa, 14 janë pajisur me certifikatë të legalizimit, dhe 32 lënde janë në pronë shoqërore dhe mbesin në listë të pritjes, dhe Lista e lejeve mjedisore, kanë qenë 24 kërkesa, në shumë prej 37,923.01€,

Kryesuesja: E hap debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (4) vota për, (2) kundër dhe (0) abstenim rekomandohet për kuvend për përkrahje, Informata nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit.

Vazhdojmë me piken 5 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, për datë 27.11.2024, në ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit